

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, studentë të kësaj njësie, si dhe Librar dhe Bibliotekar, organizuan një aktivitet me rastin e Ditës Botërore të Poezisë.

Ky aktivitet pati për qëllim njohjen e studentëve me poetë të ndryshëm, nxitjen e shkrimit dhe leximit, si dhe promovimin e poezisë.

Gjatë aktivitetit, studentët përjetuan një udhëtim në botën e poezisë, duke interpretuar dhe diskutuar krijime të ndryshme poetike, duke u bazuar veçanërisht në krijimtarinë e tre poetëve: Petrit Ruka, Ismail Xhaferri dhe Odise Kote.

Ky aktivitet u realizua nën udhëheqjen e pedagogeve Prof.Asc. Merita Gjokutaj dhe Msc. Laureta Konomi.

